

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



QERSHOR 2007

Raporti Mujo

Qershor, 2007

Personi i kontaktit: Skënder UKU
Telefon: ++355 (4) 222 920
e-mail: generalmacro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PËRMBAJTJA

VECORITË KRYESORE.....	1
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	2
1. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....	2
2. SEKTORI I JASHEM.....	5
3. SEKTORI MONETAR	6
4. SEKTORI FISKAL.....	10

TABELAT DHE GRAFIKËT MBËSHTETËS

<i>Grafiku 1</i> Ndryshimet mujore të IÇK-së në %
<i>Tabela 1</i> Ndryshimi vjetor IÇK-së
<i>Grafiku 2</i> Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë 2007
<i>Grafiku 3</i> Normat e interesit për depozitat
<i>Grafiku 4</i> Normat e interesit për huatë
<i>Grafiku 5</i> Bilanci i Pagesave
<i>Grafiku 6</i> Llogaria Korrente
<i>Grafiku 7</i> Ecuria e M.V.N. të sistemit në 2007
<i>Grafiku 8</i> Agregati M3 gjatë 2007
<i>Grafiku 9</i> Ndryshimi në oferten e parasë (Qer `06 - Qer `07)
<i>Grafiku 10</i> Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat
<i>Grafiku 11</i> Raporti Depozita/M3
<i>Grafiku 12</i> Përbërja e Depozitave
<i>Grafiku 13</i> Treguesit Fiskale për Qershor `07

VEÇORITË KRYESORE


- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Qershor, 2007 arriti në 111.4 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Qershor ishte 2.0 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Qershor 2007 ishte 91.76 lekë për dollarë dhe 123.06 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Qershor shënuan kuotat 6.03 përqind për depozitat 24 mujore, 5.73 për ato 12 mujore, 4.82 për 6 mujorët dhe 4.18 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 10.59 përqind për huatë 12 mujore dhe 13.47 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 682 miliardë lekë në muajin Qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 14 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2007* rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 30.9 milion dollarë
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Qershor, 2007 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 10.2 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara* në Janar – Qershor, 2007 arritën në rreth 115.6 miliardë lekë ose rreth 45.5 përqind e planit vjetor 2007
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 105.4 miliardë lekë ose rreth 35.05 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2007

ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Qershor 2007 pësoi një rënie prej 0.6 përqind krahasuar me muajin Maj dhe Prill 2007, kur ky indeks shënonte përkatësisht -0.8 përqind dhe - 0.2 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin - 1.1 përqind, - 0.4 përqind dhe 0.6 përqind.

Graf - 1



Ndryshimet mujore të IÇK-së

Burimi: INSTAT

Rritja më e madhe mujore, gjatë muajit qershor u konstatua në grupin “Pije alkoolike dhe duhan” me 1.0 përqind, rritje e cila erdhi si rrjedhojë e rritjes së çmimeve për cigare me rreth 1.2 përqind dhe çmimit të pijeve alkoolike me rreth 0.2 përqind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit (rreth 3.1 përqind), bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte minimale mbi normën e inflacionit. Ndikimi i tij i drejtëpërdrejtë në inflacionin mujor ishte rreth 0.03 pikë përqindje.

Gjatë këtij muaji rritje shënoi edhe indeksi i çmimeve të grupit “Mallra dhe shërbime të

ndryshme” me rreth 0.5 përqind, si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të tarifave të pagesave për kujdes personal me 0.8 përqind.

Uljen më të madhe prej 1.6 përqind këtë muaj e pësoi indeksi i çmimeve të grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike”, si rrjedhojë e uljes së çmimeve të nëngrupeve

“Zaravate përfshire patatet” me rreth 11.3 përqind, të nëngrupit “Ushqime” me rreth 1.7 përqind, si dhe e çmimeve të nëngrupit “fruta” me rreth 3.6 përqind. Pësha e lartë specifike që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit (rreth 42.6 përqind), bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte maksimale dhe të menjëhershme mbi normën e inflacionit. Ndikimi i tij i drejtëpërdrejtë në inflacionin mujor ishte 0.68 pikë përqindje.

Gjatë këtij muaji ulje prej 0.5 përqind shënoi edhe indeksi i çmimeve të grupit “Transporti”, e cila erdhi si rezultat i uljes së çmimeve të biletave për transportin ajror dhe ujor respektivisht me nga 2.6 përqind dhe 1.8 përqind. Pamvarësisht rritjes së çmimit të karburantit me 0.4 përqind ulja e çmimit të biletave ka ardhur si rezultat i flukseve të larta hyrëse e dalëse të turistëve gjatë kësaj periudhe.

Norma vjetore e inflacionit në muajin Qershor arriti në 2.0 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2006 dhe 2007 paraqiten në tabelën e mëposhtme

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2006	1.4	1.3	1.5	2.4	3.1	2.4
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2.0
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2006	3.2	2.8	2.6	2.2	2.9	2.5
2007						

Burimi: INSTAT


2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Qershor 2007, arriti në 123.06 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej 1.75 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor një euro u këmbye me 121.83 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2007, arriti në 91.76 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej 1.02 përqind kundrejt muajit Maj. Në fund të muajit Qershor, dollari amerikan arriti nivelin 90.52 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 5.58 përqind dhe është zhvlerësuar kundrejt monedhës europiane, Euro, me 0.02 përqind.

Graf - 2



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë 2007

Mbicmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare të lehte duke arritur në rreth 1.341 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë muajit Qershor përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet


në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, rritja e flukseve hyrëse në valutë si pasojë e sezonit turistik, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Qershor 2007, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 5.73 përqind, duke pësuar një rritje prej 0.34 përqind krahasuar me muajin

Graf - 3

Normat e interesit për depozitat



Maj, ku normat e interesit shënonin vlerën 5.39 përqind.

Rritje për këtë muaj kanë pësuar si depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.27 përqind, ashtu dhe normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor me 0.50 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës.


Depozitat me afat 1 - mujor pësuan rënie me 0.10 përqind për muajin Qershor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti

më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Qershor pësoi një rritje prej 0.47 përqind, duke arritur në 10.59 përqind nga 10.12 përqind që ishte në muajin Maj. Për këtë muaj normat për interesin e huave 6-mujore pësuan një rënie me

1.40 përqind, krahasuar me muajin paraardhës. Interesi i huave 6-mujore për




Graf - 4

Normat e interesit për huatë

muajin Qershor arriti në 13.47 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Qershor 2007, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht, 7.96 përqind, 7.23 përqind dhe 5.68 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 - mujor dhe 3 - mujor.

4. Bilanci i Pagesave


Graf - 5

**Bilanci i Pagesave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Qershor 2007 regjistroi një sufiçit të përgjithshëm prej 37.5 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6

**Llogaria korrente**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficietit të llogarisë korente prej 365.9 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'07-qershor'07 rezultoi:

- (i) bilanci tregtar -962 mil euro
- (ii) shërbime neto -22 mil. euro
- (iii) të ardhura neto -106 mil. euro
- (iv) transferta neto 511 mil. euro


Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në grafikun 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2007, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 199.7 milionë dollar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Graf - 7

Ecuria e M.V.N. te sistemit në 2007



Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 318.2 milionë dollarë dhe rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 118.5 milionë dollarë.

Në muajin Qershor sistemi bankar rezultoi me një rënie prej 9.9 milionë dollarë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Maj, rënie e cila

erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 49.2 milionë dollarë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 39.3 milionë dollarë.

6. Kredia për Ekonominë


Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2007 arriti në 234.6 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me një vit më parë shënoi vlerën 81.8 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 34.9 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në muajt paraardhës.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 70.8 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 166.2 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, pësoi një rritje të lehtë prej 0.5 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 35.0 përqind.

7. Oferta e Parasë


Graf - 8 Agregati M3 gjatë vitit 2007



rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Qershor ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me muajin paraardhës Maj '07. Kjo ofertë arriti në rreth 682.5 miliardë lekë në fund të muajit Qershor duke shënuar një rritje prej 8.2 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin dhjetor 2006. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 14 përqind, duke ruajtur kështu tendencën

Graf - 9 Ndryshimi në ofertën e parasë (Qer '06/Qer '07)




cilat vetëm gjatë këtij muaji u rritën me rreth 0.29 miliardë lekë.

Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 2 përqind, depozitave në valutë me rreth 27 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 22 përqind dhe rritjes të parasë jashtë sistemit me rreth 4 përqind. Ndikimin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit Qershor e kanë patur rritja e depozitave pa afat në lekë, të

Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit qershor arriti në 22.0 përqind duke shënuar në të njëjtat nivele si në muajin Maj. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Qershor arriti në rreth 28.2 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.1 përqind e krahasuar me muajin maj'07

Graf - 10

**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**


Burimi: Banka e Shqipërisë

muajit qershor, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e përbërë rreth 73.6 përqind të depozitave totale në valutë.

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 0.57 miliardë lekë në krahasim me muajin maj. Gjithashtu një rënie prej rreth 3.9 miliardë lekë në krahasim me muajin maj 2007, pësuan edhe depozitat në valutë. Norma vjetore e rritjes së tyre në fund të muajit qershor arriti në 27 përqind, duke pësuar një rënie në krahasim me muajin paraardhës.

Depozitat në valutë gjatë e sektorit privat, të cilat kanë

Graf - 11

**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve


Gjatë muajit Qershor 2007 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 61.33 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 27.98 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jofinanciare, me 8.71 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 73.1 përqind dhe rreth 21.6 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (95.76 përqind e totalit

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 438 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 532 miliardë lekë në muajin qershor 2007. Ata ndiqen nga sektori privat (73 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (16 miliardë) dhe autoritetet lokale (2.3 miliardë). Institucionet financiare kontribuuan me rreth 1.8 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit qershor 2007, krahasuar me një muaj më parë (maj '07), niveli i përgjithshëm i depozitave u ul me 4.49 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i rënies së depozitave me afat në lekë dhe të depozitave pa afat në valutë.

➤ Depozitat pa afat në lekë të familjarëve, pësuan një rritje prej rreth 0.86 miliardë lekë, ndërsa depozitat me afat në lekë të familjarëve një rënie prej rreth 0.82 miliardë lekë.

Graf - 12



Përberja e depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 438 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 532 miliardë lekë në muajin qershor 2007. Ata ndiqen nga sektori privat (73 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (16 miliardë) dhe autoritetet lokale (2.3 miliardë). Institucionet financiare kontribuuan me rreth 1.8 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit qershor 2007, krahasuar me një muaj më parë (maj '07), niveli i përgjithshëm i depozitave u ul me 4.49 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i rënies së depozitave me afat në lekë dhe të depozitave pa afat në valutë. Depozitat pa afat në lekë të familjarëve, pësuan një rritje prej rreth 0.86 miliardë lekë, ndërsa depozitat me afat në lekë të familjarëve një rënie prej rreth 0.82 miliardë lekë.


SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Qershor, janë mbledhur rreth 115.6 miliardë lekë të ardhura, përkundërt shpenzimeve të përgjithshme prej 105.4 miliardë lekë, që përfshijnë 94.2 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 11.2 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 77.6 % financim i brendshëm, dhe 22.4 % financim i huaj.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 45.5 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2007, ndërsa shpenzimet përbëjnë 35.05 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 41.8 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 16.1 % e këtij planifikimi.

Graf - 13



Treguesit Fiskal, Qershor 2007

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 81.2 miliardë lekë (ose rreth 46.7 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 5.3 miliarde lekë (40.1 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 19 miliarde lekë (44.4 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 9.9 miliardë lekë (56.8 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i

shpenzimeve korrente prej 94.2 miliarde lekë, 25.6 miliarde lekë (27.2 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 12.1 miliardë lekë (12.8 %) për interesat, 9.8 miliardë lekë (10.4 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.3 miliardë lekë (1.3 %) për subvencione, 32.3 miliardë lekë (34.4 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 7.9 miliardë lekë (8.4 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 5.2 miliardë lekë (5.5 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 43.7 % (shpenzime personeli), 40.8 % (shpenzime për interesat), 40.9 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 48.4 % (subvencione), 46.3 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 30.6 % dhe 36.2 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundërt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 23.3 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 7.8 %.

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Qershor 2007 ishin rreth 115.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 105.5 miliardë, grantet 119 miliardë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 9.9 miliardë

Tab - 2 Të ardhurat e realizuara në Janar – Qershor 2007

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	40.7
Tatimi mbi fitimin	10.6
Taksa doganore	5
Taksat nacionale	7.6
Akcizat	12.2
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	1

3. Financimi i Suficitit

Suficiti prej 10.1 miliardë lekë, për periudhën Janar-Qershor, u mbështet në vlerën 10.4 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 0.3 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa pr financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Qershor disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 22.3 miliardë lekë ose 108.6% e planit.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 18.9 miliardë lekë ose 78.5% e planit.

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesorë e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 14.8 miliardë lekë ose 102.4 % të planit të parashikuar. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 17.2 miliardë lekë ose 90.9% të planit dhe shpenzimet kapitale me 1.7 miliardë lekë ose 33.3% të planit

Apendiksi Statistikor

Tab - 1 Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit
Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)							Mesatar Mujor (Monthly Average)							Vjetor (Annual)							Mont
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	
Janar	-1.3	1.5	-0.2	-0.2	0.8	0.2	0.5	-1.3	1.5	-0.2	-0.20	0.80	0.20	0.50	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4	2.9	Januar
Shkurt	-1.3	-0.3	0.9	1.9	0.4	0.4	0.5	-1.30	0.62	0.35	0.85	0.60	0.30	0.50	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3	2.9	Februar
Mars	0.3	0.2	0.4	0.1	0.0	0.1	-0.1	-0.77	0.47	0.37	0.60	0.40	0.23	0.30	2.9	7.5	1.4	4.0	1.6	1.5	2.7	Marc
Prill	0.8	-0.1	0.8	0.0	-0.3	0.6	-0.2	-0.38	0.33	0.48	0.45	0.23	0.33	0.18	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3	2.4	1.9	Apr
Maj	0.2	-1.6	-1.1	-1.7	-1.1	-0.4	-0.8	-0.26	-0.06	0.16	0.02	-0.04	0.18	-0.02	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1	1.4	Ma
Qershor	-0.7	-1.5	-1.7	-1.4	-0.5	-1.1	-0.6	-0.33	-0.30	-0.15	-0.22	-0.12	-0.03	-0.12	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9	2.4	2.0	Jun
Korik	-1.2	-0.7	-0.4	-0.2	-1.2	-0.4		-0.46	-0.36	-0.19	-0.21	-0.27	-0.09		5.6	4.2	2.9	3.1	1.8	3.2		Jul
Gusht	-1.0	0.2	0.2	-0.2	0.2	-0.2		-0.53	-0.29	-0.14	-0.21	-0.21	-0.10		4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	2.8		Augus
Shtator	1.1	0.9	0.7	0.1	0.9	0.6		-0.34	-0.16	-0.04	-0.18	-0.09	-0.02		3.5	5.3	2.8	2.0	3.1	2.6		Septembe
Tetor	-0.4	0.1	0.2	0.2	0.4	0.1		-0.35	-0.13	-0.02	-0.14	-0.04	-0.01		1.8	5.8	2.9	2.0	3.3	2.2		Octobe
Nendor	1.9	-0.1	0.4	0.5	0.2	0.9		-0.15	-0.13	0.02	-0.09	-0.02	0.07		2.8	3.7	3.4	2.2	3.0	2.9		Novembe
Dhjetor	5.3	3.2	3.1	3.1	2.2	1.8		0.31	0.15	0.28	0.18	0.10	0.22		3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5		Decembe

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source: INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2 Kursi i kembimit
Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)

Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007						Currency
								Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	
<i>Mesatarja e periudhes</i>														<i>Average of period</i>
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	96.04	95.80	95.32	93.36	92.71	91.76	USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	124.58	125.18	126.13	126.05	125.25	123.06	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>														<i>In the end of period</i>
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	96.37	95.55	94.98	93.01	92.45	90.52	USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	124.63	126.00	126.47	126.49	124.26	121.83	EURO

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tab - 3

Normat e interesit me baze vjetore

Annual Interest Rates

2007														
Ne pergjindje Fundi i periudhes	Dhjetor '06 Dec '06	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	Tetor Oct	Nentor Nov	Dhjetor Dec	In percent End of period
Norma e remunerimit														Remuneration rate
ne leke	3.85	3.85	3.85	3.85	3.50	3.85	3.85	-	-	-	-	-	-	In Lek
ne usd	3.75	3.72	3.72	3.72	3.49	3.72	3.72	-	-	-	-	-	-	In USD
ne euro	2.57	2.53	2.61	2.71	1.86	2.78	2.88	-	-	-	-	-	-	in EURO
Norma e depozitave														Deposits rates
12-M	5.46	5.59	5.60	5.48	5.22	5.39	5.73	-	-	-	-	-	-	12-M
6-M	4.64	4.73	4.73	4.64	4.47	4.55	4.82	-	-	-	-	-	-	6-M
3-M	3.94	3.96	4.02	4.02	3.58	3.68	4.18	-	-	-	-	-	-	3-M
1-M	3.35	3.64	3.56	3.39	3.45	3.96	3.86	-	-	-	-	-	-	1-M
Norma e huase														Lending rates
12-M	11.16	12.92	13.46	11.66	10.16	10.12	10.59	-	-	-	-	-	-	12-M
6-M	12.18	16.60	14.38	12.37	15.38	14.87	13.47	-	-	-	-	-	-	6-M
Norma e letrave me vlere														Securities rates
Bobo thesari 1/														Treasury bills 1/
3-M	6.25	6.31	6.00	5.69	5.77	5.76	5.68	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	7.18	7.18	6.84	6.64	7.11	7.18	7.23	-	-	-	-	-	-	6-M
12-M	7.88	7.85	7.65	7.10	7.79	8.02	7.96	-	-	-	-	-	-	12-M

Burimi: Banka e Shqiperise

Source: Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2007
(Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2007)

Te dhena progressive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Nr.	E M E R T I M I	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	ITEM
	TOTALI TE ARDHURAVE	18,783	35,375	55,326	74,812	93,235	115,578	TOTAL REVENUE
I.	Ndihma	5	5	15	55	119	119	Grants
II.	Te ardhura tatimore	17,267	32,765	50,829	69,232	87,083	105,525	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	13,253	25,227	38,919	52,249	66,440	81,212	From tax offices and customs
	1 Tatimi mbi Vleren e Shtuar	7,104	12,908	19,690	26,421	33,602	40,669	V. A. T
	2 Tatimi mbi Fitimin	1,394	2,918	5,361	6,920	8,698	10,555	Profit Tax
	3 Akcizat	1,991	3,751	5,335	7,616	9,968	12,228	Excise Tax
	4 Tatimi mbi te Ardhurat Personale	902	1,568	2,309	3,072	3,832	5,118	Personal Income Tax
	5 Taksa Nacionale dhe te tjera	1,071	2,441	3,658	4,846	6,208	7,624	National Taxes and others
	6 Taksa Doganore	791	1,642	2,566	3,375	4,132	5,018	Custom Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	578	1,278	2,717	4,170	4,778	5,304	Revenues from Local Gov.
	1 Taksa Lokale	491	1,155	2,334	3,534	4,025	4,486	Local Taxes
	2 Tatimi mbi Biznesin e vogel	87	123	384	636	753	818	Small Business Tax
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur	3,436	6,260	9,194	12,812	15,865	19,009	Social ins
	1 Sigurimi Shoqeror	3,007	5,520	8,123	11,364	14,075	16,882	Social Insurance
	2 Sigurimi Shendetesor	429	741	1,071	1,448	1,789	2,128	Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	1,511	2,604	4,482	5,526	6,034	9,934	Nontax Revenue
	1 Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	1,010	1,010	1,010	1,010	Profit transfer from BOA
	2 Te ardhura nga Inst.Buxhetore	1,405	2,435	3,257	4,145	4,609	5,266	Income of budgetary institutions
	4 Te tjera	106	169	215	371	415	3,657	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	12,254	30,693	48,925	67,450	86,498	105,385	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	12,137	26,911	43,184	59,796	76,957	94,158	Current Expenditures
	1 Personeli	3,731	7,767	12,148	16,612	21,058	25,589	Personnel expenditures
	Paga	3,053	6,364	10,014	13,753	17,358	21,156	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	678	1,402	2,134	2,859	3,700	4,433	Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash	0	0	0	0	0	0	Of which; Contingency
	2 Interesat	2,209	3,687	5,942	7,963	10,067	12,055	Interest
	Te Brendshme	2,117	3,443	5,628	7,383	9,368	11,029	Domestic
	Te Huaja	92	244	314	580	699	1,026	Foreign
	3 Shpenzime Operative Mirembajtje	242	2,121	3,711	5,780	7,857	9,790	Operational & Maintenance
	4 Subvencionet	45	159	633	745	926	1,270	Subsidies
	Shpenzime per Sig.Sociale							
	5 dhe te tjera	0	0	0	0	0	0	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	4,784	9,896	15,279	20,919	26,555	32,346	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	4,418	8,992	13,671	18,509	23,370	28,490	Health insurance
	7 Shpenzime per Buxhetin Lokal	365	905	1,608	2,409	3,185	3,856	Local Budget
	8 Shpenzime te tjera	735	1,866	3,196	4,523	6,253	7,909	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	391	1,415	2,275	3,254	4,242	5,199	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	66	147	225	295	366	436	Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	325	1,268	2,050	2,959	3,876	4,763	Compensation for ex political prisoners
	9 Kompensim ne vlere i pronareve	0	0	0	0	0	0	Property Compensation
	Fondi Rezerve	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III.	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	117	3,782	5,741	7,654	9,541	11,227	Domestically financing
	Financimi Huaj	6	3,552	4,982	6,106	7,431	8,717	Foreign financed
		111	229	759	1,548	2,110	2,510	
	DEFICITI	0	0	0	0	0	0	Overall Deficit
	FINANCIMI DEFICITIT	6,529	4,682	6,401	7,362	6,738	10,192	Deficit Financing
	Brendshem	-6,529	-4,682	-6,401	-7,362	-6,738	-10,192	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	-6,258	-4,312	-6,416	-7,926	-7,449	-10,487	Privatization receipts
	Hua-marje e brendeshme	0	8	30	38	42	44	Domestic Borrowing
	Te tjera	2,017	4,610	2,840	6,495	2,972	3,436	Other
	I Huaj	-8,275	-8,930	-9,286	-14,459	-10,463	-13,967	Foreign
	Hua afatgjate(e marre)	-272	-371	15	564	711	295	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkës*	99	230	840	1,400	1,854	1,950	Chang. of stat. Account*
	Ripagesat	6	-6	-90	99	143	447	Repayments
		-377	-595	-735	-936	-1,286	-2,102	
	KAPITUTJ KRYESORE	0	0	0	0	0	0	Main indicators
	Financimi i Brendshem i Deficitit	-6,258	-4,312	-6,416	-7,926	-7,449	-10,487	Domestically financed deficit
	Deficiti Pergjithshem	6,529	4,682	6,401	7,362	6,738	10,192	Overall Balance
	Te ardh.-Shpen.nga Sig. Shoq.dhe Shend.	-1,348	-3,636	-6,086	-8,107	-10,690	-13,337	Soc. & health insur.contr.-outlays

* "Ndryshimi i gjendjes se arkës" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

Burimi: Ministria e Finances

Source: Ministry of Finance

Tabela 5

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2007

Expenditures by central institutions during the year 2007

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke(in million leks)

Ministria ose Institucioni	Jan	Feb	Mar	April	May	June	Ministry or Institution
Totali	12,254	30,693	48,925	67,450	86,498	105,385	Total
Presidenca	6	14	23	40	42	52	President
Kuvendi	62	123	188	247	317	388	Parliament
Keshilli i Ministrave	26	69	127	376	400	432	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	38	122	190	532	655	751	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	65	298	555	755	1,214	1,501	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	169	3,801	5,092	6,247	7,715	9,347	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Sistemi i regjistrimit te pasurise se paluajtshme	13	33	62	91	119	145	Immovable Property Registration
Ministria e Financave	21	74	101	137	175	217	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	1,423	3,088	4,979	6,994	9,114	11,111	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	47	157	260	375	484	614	Ministry of Tourism, Culture, Youth & Sport
